



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK



Nr. 671/ 10prot

Datë 03.06.2024

V E N D I M

Nr.608/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2024 me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-86181-11-02-2023, me objekt “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT’ për 12 muaj”, me fond limit 1,409,700.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK me Nipt L28029301Q dhe Adresa: *Fshatin Gurez, afër ish-Kanalit të Acidit.*

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.
Adresa: *“Rruga e Dibrës”, Nr. 372, Tiranë.*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.11.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-86181-11-02-2023, me objekt “Trajtim dhe asgjесim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT për 12 muaj”, me fond limit 1,409,700.00leke pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

II.2. Në datën 11.03.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|-----------------------------|--------------|--------------------|
| 1. “V.A.L.E Recycling” SHPK | 1.110.000 | lekë, Skualifikuar |
| 2. “ECO Riciklim” SHPK | 1.165.500.00 | lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 13.03.2024 , autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak në SPE.

II.4. Në datën 19.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3911, si dhe nr. protokollit 671/2024, datë 19.03.2024, i operatorit ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, duke argumentuar, se *“Së treti, autoriteti kontraktor ka skualifikuar OE duke u bazuar ne hamendësime mbi fakte të ardhshme që dhe nuk mund të ndodhin. Fakti që shoqeria V.A.L.E Recycling është pjesë e një inspektimi nuk mund dhe nuk duhet të prekin Autoritetin kontraktor duke qënë se autoriteti kontraktor, nëse fakti i supozuar do te ndodhte, do të shkëpuste kontratën. Së katerti, autoriteti kontraktor duke skualifikuar shoqerine V.A.L.E Recycling, ka shkelur parimin kushtetues të prezumimit te pafajfise, duke qënë se nuk ka një vendim perfundimtar per dënimin e shoqerise V.A.L.E Recycling, duke u treguar paragjykes ne vendimin e tij. Autoriteti kontraktor duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, dhe vetem ne dokumentat e tenderit pa u influencuar nga situata te jashtme te cilat nuk e prekin as ne menyre te terthorte, pa shkelur parimet e barazise se trajtimit te operatoreve ekonomik dhe pa shkelur parimet kushtetuese. Kurrsesi autoriteti kontraktor nuk mund te paragjykoje nje operator ekonomik apo te vleresoje mbi bazen e hamendesimeve apo dokumentave qe nuk jane kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit, ndaj është per t’u admiruar guximi i autoritetit kontraktor, i cili ne procesin e vleresimit shkel hapur parimin themelor të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar ne kushte hipotetike te nje pezullimi, duke krijuar kështu një precedent të rrezikshëm paligjshmërie, duke demtuar konkurencën e lirë për qëllime personale, për të drejtuar tenderin drejt nje operatori ekonomik të caktuar. Çdo shkelje ligjore e autoritetit kontraktor, konstatuar nga shoqeria V.A.L.E Recycling shpk, si te cilat kanë si qellim favorizimin e shoqërive te caktuara, apo dëmtimin e interesave te ligjshëm të sajë do të ndiqet dhe penalisht. Faza e vleresimit te ofertave duhet te udhehiqet nga parimet e Ligjit te Prokurimit Publik dhe nga dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik ne momentin e*

hapjes se ofertave si dhe nga gjendja faktike e operatorit ekonomik dhe jo nga dëshira për ta skualifikuar atë me çdo kusht, jo nga dëshira për të kaluar në operatorin ekonomik të rradhës dhe jo nga faktoret e jashtëm që kanë interes në demtimin e një operatori ekonomik. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si pjesë e këtij procesi do të mbajë përgjegjësitë e saj për dënimin e një informacioni të pakërkuar pranë autoriteteve që nuk janë pjesë të një procesi inspektimi, me qëllim demtimin në mënyrë të drejtëpërdrejtë të shoqërisë V.A.L.E Recycling, por kuresesi Autoriteti kontraktor nuk duhet të ishte pjesë e këtij turpi dhe pjesë e kësaj paligjshmerie deri në kufij të groteskes. Për sa më lart kërkojmë shfuqizimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik V.A.L.E Recycling, dhe shpalljen fituese të saj në procedurën e prokurimit me objekt trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në qashtë për 12 muaj, nga AK Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tirane, procedurë prokurimi e parashikuar për t'u zhvilluar me datë 13.11.2023, REF-86181-11-02-2023”.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot. 671/ 2, datë 20.03.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues .

Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, administruar pranë me nr. 230/5 prot., datë 12.02.2024, ku thuhet shprehimisht se:

“... trupa inspektuese pranë kësaj drejtorie konstatoi se subjekti në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit ka në funksion 1 (një) pajisje incenerimi, ndryshe nga çfarë është e miratuar në lejen mjedisore që disponon.

Për këtë arsye, ndaj subjektit “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për lejen mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 me aktivitet “Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi” në bazë të ligjit nr 10448 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, datë 07.04.2011, neni 29, pika 1, gërma c si dhe Neni 16, pika 3 është marrë masë;

Dënim administrativ kryesor:

Gjoke 1000000 Lekë (...); Neni 29, pika 3 propozojmë: pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen.”

Referuar këtij komunikimi, duke u bazuar në ligjin nr. 10448/2011 dhe ligjin nr. 10431/2011, si dhe referuar nenit 82(2) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, OE, për këtë objekt prokurimi nuk krijon bindjen për zbatimin me sukses të kontratës në të ardhmen, duke qenë se ka një procedurë administrative, e cila mund të pasojë në pezullimin apo shfuqizimin e lejes së mjedisit, me të cilën paraqitet në këtë procedurë.

II.6. Me shkresën nr. 858/3, datë 03.04.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik, nga autoriteti kontraktor, shkresa me nr. prot.671/3, datë 05.04.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje mbi Formularin e Ankesës të administruar me nr. A/2024/3911 ankimi elektronik, nga operatori ekonomik V.A.L.E Recycling” SHPK NUIS L2802931Q”, ku e ka refuzuar ate.

II.7. Në datën 20.04.2024, me nr.1136 prot, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa Nr. 671/4, datë 06.04.2024, me lëndë“ Infomacion plotësues rreth ankesës me numer aplikimi online: A/2024/3911”, nga operatori ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” SHPK.

II.8. Në datën 10.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik dërgon shkresën me Nr. 671/5 dretjuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, me lëndë “Kërkesë për Infomacion”, ku citohet [...] “ *Komisioni Prokurimit Publik për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, kërkon nga ana juaj si organe administrative te caktuara me ligj të posacëm për lëshimin e lejeve mjedisit, të na informoni si më poshtë vijon*

1. *Cila është arsyeja që operatori ekonomik V.A.L.E. Recycling” sh.p.k ka marrë masë administrative lidhur me lejen mjedisore me këto të dhëna PN-8024-01-2019 dhe cila është masa e gjobës?*
2. *A ka një Vendim Gjyqësor që kjo masë administrative (akt) është pezulluar?*
3. *Leje mjedisore e leshuar nga ana juaj me këto të dhëna PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 me Kod III.1.C , me emërtim “Leje Mjedisore e Tipit A për:Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, a është e vlefshme apo e pezulluar nga ana juaj?*
4. *Gjithashtu kërkojmë të na informoni nëse kjo leje mjedisore ka qenë e vlefshme më datë 15.01.2024 ?[...]”*

II.9 Më datë 14.05.2024, Autoriteti Kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, dërgon shkresën me Nr. 858/5, protokolluar me tonën 671/6, datë 16.05.2024, me lëndë “Përcjellje Informacioni”.[...] “*Autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (ne vijim AK) eshte njohur me kerkesën tuaj per informacion, drejtuar Agencise Kombëtare te Mjedisit dhe Qendres Kombetare te Biznesit, me nr. 671/5 prot., date 10.05.2024, administruar ne QSU "Nënë Tereza" me nr. 858/4 prot., date 13.05.2024. Sikurse jeni ne dijeni, AK ka zhvillar proceduren e prokurimit me objekt "Trajtim dhe asgjесim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike ne QSUNT per 12 muaj", me REF-86181-11-02-2023 dhe Fond limit / Vlera e pritshme e kontratave ge mund te lidhen gate Marreveshjes Kuader: 1,409,700 (nje milion e katerqind e nente mije e shtateqind) leke pa TVSH, e cila aktualisht eshte ne faze ankimi prane Komisionit te Prokurimit Publik. Ne lidhje me sa kerkohet ne shkresen tuaj, ne cilesine e pales se interesuar ju percellim kopje te njesuara te procesverbaleve te vleresimit, se bashku me korrespondencat qe AK ka patur me Agencine Kombëtare te Mjedisit per kete objekt, mbi te cilat bazohet vleresimi i ofertave nga komisioni perkates. Duke ju falënderuar paraprakisht[...]*”.

II.7. Njëpërmjet shkresës me nr. 5268/1 prot., datë 17.05.2024, protokolluar me tonën Nr. 671/7 datë 20.05.2024, me objekt: “Kthim - Përgjigje”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dërgon shkresën me përmbajtje, “Ne pergjigje te shkreses suaj nr. 671/5 Prot., date 10.05.2024, regjistruar ne AKM me nr. 5268 prot., date 13.05.2024, ju bejme me dije si vijon: 1. Masa administrative e vendosur nga inspektoriati jane si rezultat i mosplotesimit te detyrave te lena ne inspektimin me nr. ceshtje AKM-DQ-2023-000521, date 23.11.2023. Per kete arsye, subjekti eshte riinspektuar ne daten 25.01.2024 dhe me Vendimin Përfundimtar te Inspektimit Nr.AKM-DQ-2023-000535-5, date 07.02.2024 per shkak te konstatimit te shkeljeve te kerkesave ligjore te subjektit te inspektimit, ne mbeshtetje te ligjit nr. 10448 date 7.14.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Neni 29, pika 1, germa c dhe Neni 16, pika 3, eshte vendosur: • Dënim administrativ kryesor Gjore: 1 000 000 Leke, • Denimi administrativ plotesues: Referuar inspektimit te kryer ne daten 23.11.2023 me nr ceshtje AKM-DQ-2023-000521 pasi u konstatua se instalimi i inceneratorëve ne terren nuk ishte sipas kushtit nr 1 te lejes mjedisore tipi A qe disponon me PN-8024-01-2019, subjektit ju la detyre si me poshte: "Subjektit i lihet detyre te marre masat e menjehershme per percaktimin e sakte te instalimeve ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit sipas lejes mjedisore qe disponon me qellim pershtatjen e lejes mjedisore me instalimet perkatëse ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit." Gjate riinspektimit ne terren rezulton se subjekti nuk ka marre masat e duhura per realizimin e detyrave te lina. Per subjektin V.A.L.E Recycling me leje mjedisore tipi A, PN-8024-01-2019, propozojme: Pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri ne realizimin e detyrave te lena per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. Pas ushtrimit te ankimit administrativ nga subjekti, vendimi i inspektimit eshte lene ne fuqi nga Komisioni i Ankimeve ne Agjencine Kombëtare te Mjedisit, me Vendimin nr. 3025 prot., date 13.3.2024. Me propozim te Agjencise Kombetare te Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe i Mjedisit ka nxjerre Urdhrin nr. 141 date 04.04.2024, nr. 1997/5 prot., date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" shpk me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike" me vendndodhje: fshati Gurëz, afer ish-kanalit te acidit, Gurez, Fushë Kuge, Laç, Lezhe deri ne realizimin e detyrave te lina nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. 2. Me Vendimin nr. Regi. Them 7505, date 29.03.2024 te Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Tirane, eshte vendosur refuzimi i kerkeses se pales paditise per marrjen e mases se sigurimit te padise, ne ceshtjen e ngritur nga pala paditise Shoqeria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt "Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e mases se sigurimit te padise, duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024 te xjerre nga AKM Tirane" kunder AKM Tirane si pale e paditur. Cështja eshte ne proces gjyqësor per cështjen e themelit (Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024.. Me Vendimin nr.80-2024-1075 date 17.04.2024 të Gjykatës Administrative te Shkalles se Parë Tirane, eshte vendosur pranimi i kerkess se pales paditise per marrjen e masës se sigurimit te padise, ne cështjen e ngritur nga pala paditise Shoqeria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt "Marren e mases se sigurimit te padise duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr. 1997/5 date 04.04.2024 e Ministrin te Turizmit dhe Mjedisit", bere me dije nga QKB me shkresen nr. 3275/3 prot., date 25.4.2024, regjistruar ne AKM me nr. 4890 prot., date 30.04.2024. 3. Leja mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019 me date 22.04.2022 me nr. identifikimi te lejes 2929/2 në emer te subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" shpk eshte leje mjedisore e vlefshme. Me Urdhrin nr. 141 date 04.04.2024, me nr. 1997/5 prot., date 04.04.2024 te Ministrin te Turizmit dhe Mjedisit, eshte urdheruar pezullimi i kesaj leje mjedisore deri ne realizimin e detyrave te lena nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. Me Vendimin nr.80-2024-1075, date 17.04.2024, te

Gjykates Administrative te Shkallës së Parë Tirane, është pezulluar zbatimi i këtij urdhri deri në zgjidhje perfundimtare të çështjes administrative. 4. Në datën 15.01.2024 leja mjedisore me PN-8024-01-2019 është vlefshme, pasi masa administrative ishte marrë në datën 07.02.2024 me inspektimin e kryer në datë 25.01.2024 (referuar edhe më lart). Gjithashtu, bëjme me dije, se referuar kërkesave të bera nga subjekti për plotësimin e detyrave të lena nga grupi i inspektimit, në kuadër të ligjit nr. Nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Per Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer verifikimin në terren në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të Subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" shpk, për lejen e mjedisit të tipit A me PN-8024-01-2019 dhe bazuar në Procesverbalin e inspektimit me Nr.AKM-DQ-2024-000122-2 datë 25.04.2024 dhe listë verifikimin Nr.AKM-DQ-2024-000122-2/1 datë 25.04.2024, nga grupi i inspektimit nuk janë konstatuar shkelje ligjore duke përfshirë detyrat e lena. Me shkresën nr. 166 prot., datë 12.04.2024, regjistruar nr AKM me nr. 4139 prot., datë 12.4.2024, subjekti "V.A.L.E. Recycling" shpk, konfirmon pagesën vullnetare të gjores prej 1 000 000 leke, sipas vertetimit të pagesës nga Banka Kombëtare Tregtare.

II.8 Me shkresën nr. 6177/2 prot., datë 20.05.2024, protokolluar me tonën nr. 1035/12, datë 22.05.2024, Qendra Kombëtare e Biznesit ka dërguar shkresën me lëndë "Kthim Pergjigje" duke cituar "Ne pergjigje te shkresave tuaja, me nr. 1035/10 Prot., date 15.05.2024, protokolluar me QKB me nr. 6177 date 17.05.2024 dhe nr.967/11 prot., date 15.05.2024, protokolluar nga QKB me nr.6177/1 date 17.05.2024 ju informojme si me poshte: Se pari, ju bëjme me dije se, nga verifikimi i kryer në Regjistrin Kombëtar të Lejeve /Licencave dhe Autorizimeve, rezulton, se për subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, është publikuar Urdhri i Ministrisë nr.141, datë 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore për subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike". Referuar, nenit 12, të ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konstatimi i mosplotësimit të kriterëve apo shkeljes së detyrimeve behet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit ex poste. Bazuar në nenin 27, të Ligjit Nr. 10 448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, përcaktohet se: "Ministri për lejet e mjedisit të tipave A dhe B, mund të pezullojë ose të shfuqizojë lejen e mjedisit kur: b) mbajtësi i lejes nuk përfshihet kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit;....". Gjithashtu, sqarojme se referuar, pikën 11, të nenit 14, të ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar: "Çdo institucion me kompetenca të caktuara për trajtimin e një kërkesë ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtperdrejtë në regjister, për të publikuar kërkesat, ankimet dhe vendimet përkatëse dhe është i detyruar për të publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligji." Pra, nxjerrja dhe publikimi i Urdhrave të revokimit në faqen e Qendres Kombëtare të Biznesit, është kompetence e institucioneve inspektuese, pezulluese, revokuese dhe jo QKB-së. Se dyti, pranë institucionit tone, me datë 22.04.2024, është depozituar nga ana e subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me shkresën me Nr.1135Prot., datë 20.04.2024, "Vërtetim", i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Nr.extra Prot., datë 18.04.2024, me objekt: "Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ 1997/5, datë 04.04.2024, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit". Kjo çështje është gjykuar dhe është vendosur: "1. Pranësi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë. 2. Pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, Urdhër nr.141, datë 04.04.2024, të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, deri në zgjidhjen perfundimtare të çështjes administrative". Referuar, nenit 14, pika 11, të ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 "Për licencat,

autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, QKB, ka perjcelle per kompetence, kete dokumentacion, Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencise Kombetare te Mjedisit, me shkresen me nr. 3275/3Prot., date 25.04.2024, si institucion me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese. Se treti, ju bejme me dije se, nga verifikimi i kryer ne Registrin Kombetar te Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, rezulton se, subjekti "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, eshte pajisur, me Leje Mjedisi te tipit A, me numer PN-8024-01-2019, ne date 31.01.2019. Me date 22.04.2022 eshte miratuar shtimi i veprimtarise se aktivitetit, me "Aktin e Miratimit" te Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit, Nr.3781Prot., date 22.04.2022. Se katerti, lidhur me pyetjen tuaj nese leja mjedisore ka qene e vlefshme me date 15.03.2024, sqarojme se, ne Registrin Kombetar te Lejeve/Licencave dhe Autorizimeve, per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, rezulton i publikuar Urdhri i Ministrit nr. 141, date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike". Per informacion me te detajuar lidhur me revokimin e Lejes se Mjedisit te tipit A, me numër PN- 8024-01-2019, per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, lutemi ti drejtoheni institucioneve me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese referuar ligjit nr. 10081, date 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Bashkëlidhur do të gjeni:

1. Kopje te Urdhrit te Ministrit nr. 141, date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore për subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike", te publikuar ne faqen e eebit www.gkb.gov.al.
2. Kopje te "Vërtetim", te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare, Nr.extra Prot., date 18.04.2024 së bashku me shkresën percjellese te subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, Nr. 1135Prot., date 20.04.2024.
3. Kopje te Shkresës me Nr.3275/3Prot., date 25.04.2024, me lënde: "Percillet për kompetence", te Qendres Kombetare te Biznesit.

II.9 Pranë Komisionit Përkurimit Publik është depozituar ankesa e operatorit ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK me nr. 1256/2024, datë 21.05.2024, bashkëlidhur Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me nr. regj. them 97, datë 11.04.2024, ku referuar kësaj të fundit, vëren se ky vendim lidhet me Akt - miratim Leje Mjedisi Tipi A, me numër identifikimi të lejes PN 8024-01-2019. Referuar rrethanave të çështjes së Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me nr. regj. them 97, datë 11.04.2024, citohen disa nga hapat proceduralë të cilat kanë ndodhur gjatë akteve të inspektimit nga AKM ndaj shoqërisë V.A.L.E Recycling" SHPK. Referuar kësaj të fundit citohet se më datën 24.11.2024, në përfundim të inspektimit është dorëzuar procesesverbali i Inspektimit me Nr-AKM-DQ-2023-000521-2. Gjatë këtij inspektimi janë përshkruar shkeljet ligjore "Gjetjet e konstatuara ne kete procesverbal bien ne kundërshtim me kerkest te parashikuara nga neni/et e ligjit/eve: Neni 48. Ligji Nr. 10433 date 16.06.2011 "Per Inspektimin ne Republiken e Shqiperise" (pika 1 Komente: Subjekti per lejen e mjedisit Tipi A me PN 8024-01-2019 me titull instalimi "Incenerimi I mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi" ka te percaktuar 2. inceneratore EF 50 me kapacitet perpunues 60-100 kg/ cikël por nga verifikimi ne terren rezultoi se subjekti kishte te instaluar me vendodhe ushtrim aktiviteti vetem 1 incenerator EFS 50 me kapacitet perpunues 30- 50 kg/cikël. Referuar nenit 4 te ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011

"Për Lejet e Mjedisit" subjekti i lihet detyre të marie masat e menjehershme për percaktimin e sakte të instalimeve në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit sipas lejes mjedisore që disponon me qëllim përshtatjen e lejes mjedisore me instalimet përkatëse në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit, duke vendosur denim administrativ kryesor, "Paralajmerim", më pas pala kerkuese, me shkresën Nr. 6/1 prot. Date 06.12.2023 me lende "Plotesim dokumentacioni procedura e inspektimit Nr. Nr.-AKM-DQ- 2023-000521", i ka bërë me dije personit të tretë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, se për sa ishte konstatuar dhe nga Grupi i Inspektimit, mosfunksionimi i njerit prej Inceneratoreve nuk ishte në gjendje pune për shkak të një defekti Teknik dhe ishte nxjerrë nga funksioni si dhe kerkuesi po ndermerrte masat e menjehershme për zëvendësimin e tij duke i paraqitur pales se paditur dhe faturen e blerjes së inceneratorit të ri me të njëjtat parametra dhe teknologji.

Me ane të shkresës Nr. 10411 Prot., Date 13.12.2023, të personit të tretë me lende "Njoftim i vendimit përfundimtar të Inspektimit", është njoftuar pala kerkuese mbi vendimin përfundimtar të inspektimit me Nr. AKM-DQ-2023-000521-5, date 12.12.2023, me përmbajtje dhe denim i njëjtit me atë të procesverbalit të Inspektimit Ni.-AKM-DQ-2023-000521-2, por me afat të përmbushjes së detyrave deri në datën 24.01.2024.

Me shkresën Nr. 755 Prot. Date 15.01.2024 me lende "Kerkese për shtyrje afati/procedura e inspektimit Nr. AKM-DQ-2023-000521" kerkuesi i ka bërë me dije personit të tretë se ka nisur menjehere me marrjen e masave për zëvendësimin e inceneratorit të dale jashtë funksionit duke i paraqitur faturen e blerjeve dhe i ka bërë me dije se me datë 23.12.2023 është bërë nisja nga Porti i Qingdao-QQCTU Qingdao Qiannean United CTN Kinë drejt Portit të Durrësit, ka nisur riorganizimin e aktivitetit në të gjithë instalimin duke saktësuar pajisjet ekzistuese, Zëvendësimin e pajisjeve të demtuara, Instalimin e pajisjeve të reja si dhe nisjen e procedurave për ndryshimin e kushteve të Lejes Mjedisore me PN 8024-01-2019. Gjithashtu me ane të kësaj kerkese, ka kerkuar shtyrjen e afatit të riinspektimit me të pakten 30 ditë pune për shkak të vonës në transportin e pajisjes së re të blerë (incenerimit). Bashkëlidhur kësaj kerkese kerkuesi i ka vënë në dispozicion personit të tretë një kopje të dokumentacionit që provonte pretendimet e tij.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes "V.A.L.E RECYCLING" SHPK me arsyetimin, se "Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, administruar pranë me nr. 230/5 prot., datë 12.02.2024, ku thuhet shprehimisht se:

“... trupa inspektuese pranë kësaj drejtorie konstatoi se subjekti në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit ka në funksion 1 (një) pajisje incenerimi, ndryshe nga çfarë është e miratuar në lejen mjedisore që disponon.

Për këtë arsye, ndaj subjektit “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për lejen mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 me aktivitet “Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi” në bazë të ligjit nr 10448 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, datë 07.04.2011, neni 29, pika 1, gërma c si dhe Neni 16, pika 3 është marrë masë;

Dënim administrativ kryesor:

Gjobe 1000000 Lekë (...); Neni 29, pika 3 propozojmë: pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen.”

Referuar këtij komunikimi, duke u bazuar në ligjin nr. 10448/2011 dhe ligjin nr. 10431/2011, si dhe referuar nenit 82(2) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, OE, për këtë objekt prokurimi nuk krijon bindjen për zbatimin me sukses të kontratës në të ardhmen, duke qenë se ka një procedurë administrative, e cila mund të pasojë në pezullimin apo shfuqizimin e lejes së mjedisit, me të cilën paraqitet në këtë procedurë...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar sa më lart, Komisioni Prokurimit Publik vlerësoi të nevojshme kërkesën për informacion drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, ku dërgoi shkresën me Nr. 671/5, me lënde “Kërkesë për Infomacion” ku citohet[...] “Komisioni i Prokurimit Publik për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, kërkon nga ana juaj si organe administrative te caktuara me ligj të posacëm për lëshimin e lejeve mjedisit, të na informoni si më poshtë vijon

1. Cila është arsyeja që operatori ekonomik V.A.L.E. Recycling” sh.p.k ka marrë masë administrative lidhur me lejen mjedisore me këto të dhëna PN-8024-01-2019 dhe cila është masa e gjobës?

2. A ka një Vendim Gjyqësor që kjo masë administrative (akt) është pezulluar?

3. Leje mjedisore e leshuar nga ana juaj me këto të dhëna PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 me Kod III.1.C, me emërtim “Leje Mjedisi e Tipit A për:Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, a është e vlefshme apo e pezulluar nga ana juaj?

4. Gjithashtu, kërkojmë të na informoni nëse kjo leje mjedisore ka qenë e vlefshme më datë 15.01.2024 ?[...]”

III.1.2 Referuar sa më lart, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, ktheu përgjigje me shkresën nr 5268/1 prot., datë 17.05.2024, protokolluar me tonën Nr. 671/7 datë 20.05.2024, me objekt: “Kthim - Përgjigje”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me përmbajtje “Ne pergjigje te shkreses suaj nr. 671/5 Prot., date 10.05.2024, regjistruar ne AKM me nr. 5268 prot., date 13.05.2024, ju bejme me dije si vijon: 1. Masa administrative e vendosur nga inspektoriati jen si rezultat i mosplotesimit te detyrave te lena ne inspektimin me nr. ceshtje AKM-DQ-2023-000521, date 23.11.2023. Per kete arsye, subjekti shte riinspektuar

ne date 25.01.2024 dhe me Vendimin Përfundimtar te Inspektimit Nr.AKM-DQ-2023-000535-5, date 07.02.2024 per shkak te konstatimit te shkeljeve te kerkesave ligjore te subjektit te inspektimit, ne mbeshtetje te ligjit nr. 10448 date 7.14.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Neni 29, pika 1, germa c dhe Neni 16, pika 3, eshte vendosur: • Dënim administrativ kryesor Gjobe: 1 000 000 Leke, • Denimi administrativ plotesues: Referuar inspektimit te kryer ne daten 23.11.2023 me nr. cështje AKM-DQ-2023-000521, pasi u konstatua se instalimi i inceneratoreve ne terren nuk ishte sipas kushtit nr 1 te lejes jedisore tipi A qe disponon me PN-8024-01-2019, subjektit ju la detyre si me poshte: "Subjektit i lihet detyre te marre masat e menjehershme per percaktimin e sakte te instalimeve ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit sipas lejes mjedisore qe disponon me qellim pershtatjen e lejes mjedisore me instalimet perkatëse ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit." Gjate riinspektimit ne terren rezulton se subjekti nuk ka marre masat e duhura per realizimin e detyrave te lëna. Per subjektin V.A.L.E Recycling me leje mjedisore tipi A, PN-8024-01-2019, propozojme: Pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri ne realizimin e detyrave te lina per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit.

Pas ushtrimit te ankimit administrativ nga subjekti, vendimi i inspektimit eshte lene ne fuqi nga Komisioni i Ankimeve ne Agencine Kombëtare te Mjedisit, me Vendimin nr. 3025 prot., date 13.3.2024. Me propozim te Agencise Kombetare te Mjedisit, Ministri i Turizmit dine Mjedisit ka nxjerre Urdhrin nr. 141 date 04.04.2024, nr. 1997/5 prot., date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" shpk me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike" me vendndodhje: fshati Gurëz, afer ish-kanalit te acidit, Gurez, Fushë Kuge, Laç, Lezhe deri ne realizimin e detyrave te lina nga Agencia Kombëtare e Mjedisit per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. 2. Me Vendimin nr. Regi. Them 7505 date 29.03.2024 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, eshte vendosur refuzimi i kerkeses se pales paditise per marrjen e mases se sigurimit te padise, ne ceshtjen e ngritur nga pala paditise Shogeria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt "Shfugizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e mases se sigurimit te padise duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024 te xjerre nga AKM Tirane" kunder AKM Tirane si pale e paditur. Cështja eshte ne proces gjyqësor per cështjen e themelit (Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024). Me Vendimin nr.80-2024-1075 date 17.04.2024 të Gjykatës Administrative te Shkalles se Parë Tirane, eshte vendosur pranimi i kerkess se pales paditise per marrjen e masës se sigurimit te padise, ne cështjen e ngritur nga pala paditise Shoqeria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt "Marrjen e mases se sigurimit te padise duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr. 1997/5 date 04.04.2024 e Ministrin te Turizmit dhe Mjedisit", bere me dije nga QKB me shkresen nr. 3275/3 prot., date 25.4.2024, regjistruar ne AKM me nr. 4890 prot., date 30.04.2024. 3. Leja mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019 me date 22.04.2022 me nr. identifikimi te lejes 2929/2 në emer te subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" shpk eshte leje mjedisore e vlefshme. Me Urdhrin nr. 141 date 04.04.2024, me nr. 1997/5 prot., date 04.04.2024 te Ministrin te Turizmit dhe Mjedisit, eshte urdheruar pezullimi i kesaj leje mjedisore deri ne realizimin e detyrave te lina nga Agencia Kombëtare e Mjedisit per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. Me

Vendimin nr.80-2024-1075 date 17.04.2024 te Gjykates Administrative te Shkallës se Parë Tirane, eshte pezulluar zbatimimi i këtij urdhri deri ne zgjidhjen perfundimtare te çështjes administrative. 4. Në datën 15.01.2024 leja mjedisore me PN-8024-01-2019 eshte e vlefshme, pasi masa administrative ishte marre ne date 07.02.2024 me inspektimin e kryer ne date 25.01.2024 (referuar edhe me lart). Gjithashtu bejme me dije se, referuar kerkesave te bera nga subjekti per plotesimin e detyrave te lena nga grupi i inspektimit, ne kuader te ligjit nr. Nr. 10 433, date 16.6.2011 "Per Inspektimin ne Republikën e Shiperise" dhe ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" i ndryshuar, Agencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer verifikimin ne terren ne ambientet e ushtrimit te aktivitetit të Subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" shpk, per lejen e mjedisit te tipit A me PN-8024-01-2019 dhe bazuar ne Procesverbalin e inspektimit me Nr.AKM-DQ-2024-000122-2 date 25.04.2024 dhe liste verifikimin Nr.AKM-DQ-2024-000122-2/1 date 25.04.2024, nga grupi i inspektimit nuk jane konstatuar shkelje ligjore duke permbushur detyrat e lena. Me shkresën nr. 166 prot., date 12.04.2024, regjistruar nr AKM me nr. 4139 prot., date 12.4.2024, subjekti "V.A.L.E. Recycling" shpk, konfirmon pagesen vullnetare te gjores prej 1 000 000 leke, sipas vertetimit te pageses nga Banka Kombëtare Tregtare.

III.1.3 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka marrë vendimin "Për Sigurimin e Padisë" me, Nr. Regj. Them 97 [300004-03173-80-2024], datë 11.04.2024, duke cituar se " Se kerkuesi Shoqeria V.A.LE RECYCLING shpk, me date 12.04.2024 ka depozituar ne sekretarine e Gykatës Administrative te Shkallës se Pare Gjirokaster kerkesen me objekt si ne pjesen hyrese te vendimit.

Kerkese e cila i eshte neshktruar shortit elektronik. Pas shortimit elektronik, kerkesa objekt shqyrtimi gjyqësor me date 17.04.2023, i eshte dorezuar per gjykim këtij trupi gjykues. Gjykata, nisur nga fakti i mesiperme kur kerkesa eshte depozituar ne sekretarine e Gjykates më date 12.04.2024 dhe eshte marre per shqyrtim nga ky trup gjykues me date 17.04.2024 si dhe ne afatin 5 ditor te shqyrtimit te ceshtjes te percaktuar ne dispoziten ligjore neni 28 te Ligjit 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative", vendosi te shqyrtoje kerkesën per marrje mase sigurimi padie në dhome keshillimi, pa pranine e paleve ndergjyqëse.

RRETHANAT E CESHTJES

Gjate shqyrtimit gjyqësor te çështjes, rezultoi se kerkues eshte shoqeria V.A.LE RECYCLING shpk, NUIS L28029301Q, me seli Lezhe Fushe Kuqe, Gurez, afer ish kanalit te Acidit, e cila ka per objekt te aktivitetit te saj tregtar nder te tjera: grumbullimin, administrimin, transportimin dhe perpunimin e mbetjeve urbane, mbetjeve te posaçme dhe mbetjeve spitalore.

Kerkuesi, ne kuader te zhvillimit te aktivitetit të tij tregtar, është pajisur me Lejen Mjedisore te Tipit A Nr. PN 8024-01-2019.

Ne daten 24.11.2023, nga personi i trete eshte ushtruar inspektim prane kerkuesit ku ne perfundim te tij nga Grupi i Inspektimit eshte dorezuar Procesverbali Inspektimit Nr.-AKM-DQ- 2023-000521-2.

Ne seksionin Gjetjet e Konstatuara, nga grupi i Inspektimit janë pershkruar keto shkelje ligjore: Gjetjet e konstatuara ne kete procesverbal bien ne kundershkrim me kerkesat te parashikuara nga neni/et e ligjit/eve: Neni 48. Ligji Nr. 10433 date 16.06.2011 "Per Inspektimin ne Republiken e Shiperise" (pika 1 Komente: Subjekti per lejen e mjedisit Tipi A me PN 8024-01-2019 me titull instalimi "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi" ka te percaktuar 2. inceneratore EF 50 me kapacitet perpunues 60-100 kg/ cikel por nga verifikimi ne terren rezultoi se subjekti kishte te instaluar me vendndodhje ushtrim aktiviteti vetem 1 incenerator EFS 50 me kapacitet perpunues 30- 50 kg/cikel. Referuar nenit 4 te ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" subjektit i lihet detyre te marre masat e menjehershme per percaktimin e sakte te instalimeve ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit sipas lejes mjedisore qe disponon, me qellim pershtatjen e lejes mjedisore me instalimet perkatese ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit, duke vendosur denim administrativ kryesor, Paralajmerim.

Pala kerkuese, me shkresën Nr. 6/1 prot. Date **06.12.2023** me lende "Plotesim dokumentacioni procedura e inspektimit Nr. Nr.-AKM-DQ- 2023-000521", i ka bere me dije personit te trete Ministrise së Turizmit dhe Mjedisit, se per sa ishte konstatuar dhe nga Grupi i Inspektimit, mosfunksionimi i njerit prej Inceneratoreve nuk ishte ne gjendje pune per shkak te nje difekti Teknik dhe ishte nxjerre nga funksioni si dhe kerkuesi po ndermente masat e menjehershme per zevendesimin e tij duke i paraqitur pales se paditur dhe faturen e blerjes se inceneratorit te ri me te njejta parametra dhe teknologji.

Me ane te shkreses Nr. 10411 Prot. Date **13.12.2023** te personit te trete me lende "Njoftim I vendimit perfundimtar te Inspektimit" eshte njoftuar pala kerkuese mbi vendimin perfundimtar te inspektimit me Nr. AKM-DQ-2023-000521-5 date 12.12.2023 me permbatje dhe denim i njejte me ate te procesverbalit te Inspektimit Ni.-AKM-DQ-2023-000521-2. por me afat te permbushjes se detyrave deri ne daten 24.01.2024.

Me shkresën Nr. 755 Prot. Date **15.01.2024** me lende "Kerkese per shtyrje afati/procedura e inspektimit Nr. AKM-DQ-2023-000521" **kerkuesi i ka bere me dije personit te trete se ka nisur menjehere me marrjen e masave per zevendesimin e inceneratorit te dale jashte funksionit duke i paraqitur faturen e blerjeve dhe i ka bere me dije se me date 23.12.2023** eshte bere nisja nga Porti i Qingdao-QQCTU Qingdao Qiannean United CTN Kine drejt Portit te Durrës, ka nisur riorganizimin e aktivitetit ne te githe instalimin duke sakesuar pajisjet ekzistuese, Zevendesimin e pajisjeve te demtuara, Instalimin e pajisjeve te reja si dhe nisjen e procedurave per ndryshimin e kushteve te Leies Mjedisore me PN 8024-01-2019. Gjithashtu me ane te kesaj kerkese, ka kerkuar shtyjen e afatit te riinspektimit me te pakten 30 dite pune per shkak te voneses ne transportin e pajisjes se re te blere (incenerimit), Bashkelidhur kesaj kerkese kerkuesi i ka vene ne dispozicion personit te trete nje kopje te dokumentacionit qe provonte pretendimet e tij.

Personi i trete me date **25.01.2024** ka ushtruar perseri inspektimin prane pales kerkuese.

Grupi i Riinspektimit ne perfundim te inspektimit te kryer, referuar Proceverbalit te Inspektimit Nr. AKM-DQ-2023-000535-2 date **25.01.2024** ka pershkruar shkelje ligjore: Gjetjet e konstatuara ne ketë procesverbal bien ne kundersizim me kerkesat te parashikuara nga neni/et e ligjit/eve: Neni 16 te ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" i ndryshuar Pika 3 Komente: Gjate Inspektimit te bire me date 23.11.2023 deklaroi se nuk ka patur incidente ne instalim. Ne kontestimet e dorezuara prane AKM-se me nr. 611 prot. Date 06.12.2023 Lënda "Plotesim dokumentacioni per proceduren e inspektimit Nr. AKM-DQ-2023-000521" per gjetjet e lena dhe procesverbal deklaroi ne piken 3 te kesaj shkese: **Si rezultat i dëmtimeve te pariparueshme të pajisjes se incenerimit, kjo e fundit eshte nxjerrë jashte funksionit".**

Subjekti referuar kushtit 6 pika 6.3 te lejes mjedisore ge disponon ka detyrimin ligjor per te njoftuar sa me shpejt AKM-ne. Subjekti nuk ka njoftuar me shkrese zyrtare prane AKM-se per mosfunksionimin dhe daljen jashtë funksioni te njerit prej inceneratoreve e disponon sipas lejes mjedisore me PN-8024-01-2019. Neni 29 Ligjit Nr. Nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit i ndryshuar Pika 3 Komente: Referuar inspektimit te kryer me datën 23.11.2023 me nr. Cështje Akm-DQ-2023-000521 pasi u konstatua se instalimi i inceratoreve ne terren nuk ishte sipas kushtit nr. 1 te lejes mjedisore tipi A që disponon me PN-8024-01-2019, subjektit ju la detyre si me poshte;

Subjektit i lihet detyre te marre masat e menjehershme per percaktimin e sakte te instalimeve ne vendodhjen e aktivitetit te tij sipas lejes mjedisore qe disponon me qellim pershtatjen e lejes mjedisore me instalimet perkatese ne vendndodhjen e aktivitetit. **Gjate riinspektimit ne terren rezulton, se subjekti nuk ka marrë masat e duhura per realizimin e detyrave te lëna. Per subjektin VALE RECYCLING me leje mjedisore tipi A PN*-8024-01-2019 propozojme:**

Pezullimin e lejes mjedisore tipi A me PN PN*- 8024-01-2019 deri ne realizimin e detyrave te lena per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin ne vendodhjen e ushtrimit te aktivitetit. Si denim Kryesor denimin e pales paditese me 1 000 000 lek gjobe dhe denim administrativ plotesues Referuar inspektimit te kryer me daten 23.11.2023 me nr. Cështje Akm-DQ-2023-000521 pasi u konstatua se instalimi i inceneratoreve ne terren nuk ishte sipas kushtit nr. 1 te lejes mjedisore tipi A qe disponon me PN-8024-01-2019, subjektit iu la detyre si me poshte: **Subjektit i lihet detyre te marre masat e menjehershme per percaktimin e sakte te instalimeve ne vendndodhjen e aktivitetit te tij sipas lejes mjedisore qe disponon me qellim pershtatjen e lejes mjedisore me instalimet perkatese ne vendodhjen e aktivitetit. Gjatë riinspektimit ne terren rezulton, se subjekti nuk ka marre masat e duhura per realizimin e detyrave te lëna. Per subjektin VALE RECYCLING me leje mjedisore tipi A PN-8024-01-201 propozojme: Pezullimin e lejes mjedisore tipi A me PN PN*-8024-01-2019.**

Me date 31.01.2024, me ane te shkresës nr. 856 Prot. Date 31.01.2024, me lënde: "Konstantimin e procesverbalit te kontrollit nr. AKM-DQ-2023-000521 date 25.01.2024" kerkuesi ka paraqitur prane personit te trete kundersizimet e tij lidhur me pretendimet dhe shkeljet e pretenduara nga Grupi i Riinspektimit.

Me shkresën Nr. 31.01.2024 me lënde "Kerkese per marjen pjese ne komisionin e shqyrtimit te ankesave per proceduren e riinspektimit AKM-DQ-000535-1 date 25.01.2024" kerkuesi ka kerkuar te ishte prezent gjate shqyrtimit te ankeses se tij dhe te degjohej e te jepte shpjegimet e tij perpara vendimit perfundimtar te inspektimit.

Personi i trete, me shkresën e dates 08.02.2024 i ka dërguar kerkuesit Njoftimi i vendimit perfundimtar te inspektimit.

Ndaj kete vendimi pala kerkuese ka paraqitur ankim administrativ nepermjet shkreses se dates 22.02.2024 Nr. 978 prot.

Me shkresën Nr. 24.02.2024 Nr. 979 Prot. me lende "Kerkese per marrjen pjese ne komisionin e shqyrtimit te ankesave kunder Vendimit perfundimtar te Kontrollit AKM-DQ- 000535-5 date 07.02.2024", kerkuesi ka kerkuar te ishte prezent gjate shqyrtimit te ankeses se tij dhe te degjohej e te jepte shpjegimet e tij perpara vendimit perfundimtar.

Me date 12.03.2024, ne prani te perfaqesuesit ligjor te personit te trete eshte zhvilluar seanca degjimore lidhur me pretendimet e pales paditese.

Personi i trete me ane te shkreses Nr. 3025/1 Prot. Datë 13.03.2024, ka njoftuar palen kerkuese vendimin e Komisionit te Ankimit Nr. 3025 date 13.03.224, nepermjet te cilit eshte vendosur: Lenien ne fuqi te Vendimit Perfundimtar te Inspektimit Nr. AKM-DQ-2023-000535-5 date 07.02.2024 te Agencise Kombetare te Mjedisit ndaj V.A.LE RECYCLING shpk per masen administrative kryesore gobe me vleren 1 000 000 lek dhe denim administrativ plotësues/ Mospranimin e ankimit ndaj ketij akti administrativ. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Tirane.

Ne vijim nga ana e Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit, eshte njoftuar kerkuesi lidhur me Urdhrin e nxjerre nr. 1997/5 date 04.04.2024 ne te cilin eshte vendosur: Pezullimin e Lejes Mjedisore per subjektin VA.LE RECYCLING shpk me PN8024-01- 2019 me veprimtari "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme me nje instalim incerimi i mbetjeve patologjike" me vendndodhje Fshati Gurëz afer ish kanalit te acidit Fushë Kuqe, Laç, Lezhe, deri ne realizimin e detyrave te lena nga Agencia Kombetare Mjedisit per pershtatjen e lejes mjedisore me instalim ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit..

Subjekti kerkues me njohjen e aktit te mësiperm i eshte drejtuar Gjykatës me kerkesen objekt shqyrtimi gjyqësor.

III.1.4 Në shtojcën 8 “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika 2.2.1 “të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Leje Mjedisi sipas Ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011**, i ndryshuar, **Leje Mjedisi të Tipit A (Kat. 5.1.a)**, ku mbetjet do të asgjësohen brenda territorit të RSH (nëpërmjet metodës së Incenerimit) ose nëse mbetjet objekt i kësaj procedure prokurimi trajtohen/asgjësohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur të paktën me **Leje Mjedisi të Tipit B (Kat. 5.10.a) si dhe Licencë III.2.B**, të leshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të vlefshme në momentin e hapjes së tenderit.

Shënim: OE që kryen trajtimin/asgjësimin jashtë territorit të RSH, përpara se të bëjë eksportin e mbetjeve jashtë territorit të RSH, duhet të jetë i pajisur me Autorizim për eksport të mbetjeve, të leshuar nga Ministria përgjegjëse për mjedisin (MTM) sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve” apo akteve ligjore në fuqi.

- b) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Licence III.2.B**, të leshuar nga QKB për trajtimin/asgjësimin apo trajsportin (në rastet kur mbetjet eksportohen jashtë territorin të RSH) e mbetjeve spitalore të rrezikshme, të vlefshme në momentin e hapjes së tenderit.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Certifikate ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent**, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.**
- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Certifikaten “ISO 14001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose Verifikimi EMAS (CE/1221/2009) mbi “EKO – Menaxhimi dhe Sistemi I Auditimit”**, në përputhje me objektin e prokurimit ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.**
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Certifikaten “45001:2018 “Mbi menaxhimin e standardeve të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent**, në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.**

III.1.3. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet

publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.1.5. Në nenin 41, pika 4 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Në nenin 76, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Neni 76

Kriteret detyruese për skualifikim

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) **autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;**

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriteve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me dokumentat standarte të tenderit të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Vlen të theksohet, se kërkesat e dokumenteve të tenderit duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me

legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen e ofertuesve të mundshëm në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi, i pajisur me licencën përkatëse sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit ku autoriteti kontraktor citon se “ Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, administruar pranë me nr. 230/5 prot., datë 12.02.2024, ku thuhet shprehimisht se:

“... trupa inspektuese pranë kësaj drejtorie konstatoi se subjekti në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit ka në funksion 1 (një) pajisje incenerimi, ndryshe nga çfarë është e miratuar në lejen mjedisore që disponon.

Për këtë arsye, ndaj subjektit “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për lejen mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 me aktivitet “Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi” në bazë të ligjit nr. 10448 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, datë 07.04.2011, neni 29, pika 1, gërma c si dhe Neni 16, pika 3 është marrë masë;

Dënim administrativ kryesor:

Gjobe 1000000 Lekë (...); Neni 29, pika 3 propozojmë: pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen.”

Referuar këtij komunikimi, duke u bazuar në ligjin nr. 10448/2011 dhe ligjin nr. 10431/2011, si dhe referuar nenit 82(2) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, OE, për këtë objekt prokurimi nuk krijon bindjen për zbatimin me sukses të kontratës në të ardhmen, duke qenë se ka një procedurë administrative, e cila mund të pasojë në pezullimin apo shfuqizimin e lejes së mjedisit, me të cilën paraqitet në këtë procedurë.

Komisionit të Prokurimit Publik, për një gjykim sa më të drejtë, iu shfaq nevoja për informacion lidhur me lejen mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 të operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, duke iu drejtuar me shkresën Nr. 671/5, datë 10.05.2024, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit me pyetjet si më poshtë vijon “ [...]

1. Cila është arsyeja që operatori ekonomik V.A.L.E. Recycling” sh.p.k ka marrë masë administrative lidhur me lejen mjedisore me këto të dhëna PN-8024-01-2019 dhe cila është masa e gjobës?
2. A ka një Vendim Gjyqësor që kjo masë administrative (akt) është pezulluar?
3. Leje mjedisore e leshuar nga ana juaj me këto të dhëna PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 me Kod III.1.C, me emërtim “Leje Mjedisore e Tipit A për: Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, a është e vlefshme apo e pezulluar nga ana juaj?
4. Gjithashtu kërkojmë të na informoni nëse kjo leje mjedisore ka qenë e vlefshme më datë 15.01.2024 ?[...]

Referuar sa më lart kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, ka vënë në dispozicion kthim - përgjigje me shkresën nr 5268/1 prot., datë 17.05.2024, protokolluar me tonën Nr. 671/7, datë 20.05.2024 me objekt: "Kthim - Përgjigje", ku Agjencia Kombëtare e Mjedisit kthen përgjigje me përmbajtje "Ne pergjigje te shkreses suaj nr. 671/5 Prot., date 10.05.2024, regjistruar ne AKM me nr. 5268 prot., date 13.05.2024, ju bejme me dije si vijon: 1. Masa administrative e vendosur nga inspektoriat i vjen si rezultat i mosplotesimit te detyrave te lena ne inspektimin me nr. ceshtje AKM-DQ-2023-000521, date 23.11.2023. Per kete arsye, subjekti eshte riinspektuar ne date 25.01.2024 dhe me Vendimin Përfundimtar te Inspektimit Nr.AKM-DQ-2023-000535-5, date 07.02.2024 per shkak te konstatimit te shkeljeve te kerkesave ligjore te subjektit te inspektimit, ne mbeshetjetje te ligjit nr. 10448 date 7.14.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Neni 29, pika 1, germa c dhe Neni 16, pika 3, eshte vendosur: • Dënim administrativ kryesor Gjore: 1 000 000 Leke, • Denimi administrativ plotesues: Referuar inspektimit te kryer ne daten 23.11.2023 me nr ceshtje AKM-DQ-2023-000521 pasi u konstatua se instalimi i inceneratorëve ne terren nuk ishte sipas kushtit nr 1 te lejes mjedisore tipi A ge disponon me PN-8024-01-2019, subjektit ju la detyre si me poshte: "Subjektit i lihet detyre te marre masat e menjehershme per percaktimin e sakte te instalimeve ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit sipas lejes mjedisore qe disponon me qellim pershtatjen e lejes mjedisore me instalimet perkatëse ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit." Gjate riinspektimit ne terren rezulton se subjekti nuk ka marre masat e duhura per realizimin e detyrave te lena. Per subjektin V.A.L.E Recycling me leje mjedisore tipi A, PN-8024-01-2019, propozojme: Pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri ne realizimin e detyrave te lena per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. Pas ushtrimit te ankimit administrativ nga subjekti, vendimi i inspektimit eshte lene ne fuqi nga Komisioni i Ankimeve ne Agencine Kombëtare te Mjedisit, me Vendimin nr. 3025 prot., date 13.3.2024. Me propozim te Agencise Kombetare te Mjedisit, Ministri i Turizmit dine Mjedisit ka nxjerre Urdhrin nr. 141 date 04.04.2024, nr. 1997/5 prot., date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" shpk me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike" me vendndodhje: fshati Gurëz, afer ish-kanalit te acidit, Gurez, Fushë Kuge, Laç, Lezhe deri ne realizimin e detyrave te lina nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. 2. Me Vendimin nr. Regi. Them 7505 date 29.03.2024 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, eshte vendosur refuzimi i kerkeses se pales paditise per marrjen e mases se sigurimit te padise, ne ceshtjen e ngritur nga pala paditise Shogeria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt "Shfugizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e mases se sigurimit te padise duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024, te nxjerre nga AKM Tirane" kunder AKM Tirane si pale e paditur. Cështja eshte ne proces gjyësor per cështjen e themelit (Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024.. Me Vendimin nr.80-2024-1075 date 17.04.2024 të Gjykatës Administrative te Shkalles se Parë Tirane, eshte vendosur pranimi i kerkeses se pales paditise per marrjen e masës së sigurimit te padise, ne cështjen e ngritur nga pala paditise Shoqeria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt "Marren e mases se sigurimit te padise duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr. 1997/5 date 04.04.2024 e Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit", bere me dije nga QKB me shkresen nr. 3275/3 prot., date 25.4.2024, regjistruar ne AKM me nr. 4890 prot., date 30.04.2024. 3. Leja mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019 me date 22.04.2022 me nr. identifikimi te lejes 2929/2 në emer te subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" shpk eshte leje mjedisore e vlefshme. Me Urdhrin nr. 141 date 04.04.2024, me nr. 1997/5 prot., date 04.04.2024 te Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit, eshte urdheruar pezullimi i kesaj leje mjedisore deri ne realizimin e detyrave te lena nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit per pershtatjen e lejes mjedisore me instalimin në

vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit. Me Vendimin nr.80-2024-1075 date 17.04.2024 te Gjykates Administrative te Shkallës se Parë Tirane, eshte pezulluar zbatimi i kitij urdhri deri ne zgjidhje perfundimtare te çështjes administrative. 4. Në datën 15.01.2024 leja mjedisore me PN-8024-01-2019 eshte e vlefshme, pasi masa administrative ishte marre ne date 07.02.2024 me inspektimin e kryer ne date 25.01.2024 (referuar edhe me lart). Gjithashtu, bejme me dije se, referuar kerkesave te bera nga subjekti per plotesimin e detyrave te lena nga grupi i inspektimit, ne kuader te ligjit nr. Nr. 10 433, date 16.6.2011 "Per Inspektimin ne Republikën e Shqiperise" dhe ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer verifikimin ne terren ne ambientet e ushtrimit te aktivitetit të Subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" shpk, per lejen e mjedisit te tipit A me PN-8024-01-2019 dhe bazuar ne Procesverbalin e inspektimit me Nr.AKM-DQ-2024-000122-2 date 25.04.2024 dhe liste verifikimin Nr.AKM-DQ-2024-000122-2/1 date 25.04.2024, nga grupi i inspektimit nuk jane konstatuar shkelje ligjore duke permbushur detyrat e lena. Me shkresën nr. 166 prot., date 12.04.2024, regjistruar nr AKM me nr. 4139 prot., date 12.4.2024, subjekti "V.A.L.E. Recycling" shpk, konfirmon pagesen vullnetare te giobes prej 1 000 000 leke, sipas vertetimit te pageses nga Banka Kombëtare Tregtare. dhe shkresa nr. 6177/2 prot., datë 20.05.2024, protokolluar me tonën nr. 1035/12, datë 22.05.2024, nga Qendra Kombëtare e Biznesit duke cituar " Ne pergjigje te shkresave tuaja, me nr. 1035/10 Prot., date 15.05.2024, protokolluar me QKB me nr. 6177 date 17.05.2024 dhe nr.967/11 prot., date 15.05.2024, protokolluar nga QKB me nr.6177/1 date 17.05.2024 ju informojme si me poshte: Se pari, ju bejme me dije se, nga verifikimi i kryer ne Regjistrin Kombëtar te Lejeve /Licencave dhe Autorizimeve, rezulton se, per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, shtë publikuar Urdhri i Ministrit nr.141, date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes medisore per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme në nje instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike". Referuar, nenit 12, te ligjit nr. 10 081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqiperise", i ndryshuar, konstatimi i mosplotesimit te kritereve apo shkeljes se detyrimeve behet, si regull, nga organet kompetente te inspektimit ex poste. Bazuar në nenin 27, te Ligjit Nr. 10 448, date 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, percaktohet se: "Ministri per lejet e mjedisit te tipave A dhe B, mund te pezullojë ose të shfuqizojë lejen e mjedisit kur: b) mbajtësi i lejes nuk permbush kushtet e parashikuara ne lejen e mjedisit;....". Gjithashtu, sqarojme se referuar, pikes 11, të nenit 14, te ligjit nr. 10 081, date 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqiperise", i ndryshuar: "Çdo institucion me kompetenca te caktuara per trajtimin e nje kerkese ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh nje ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtperdrejte ne regjister, per të publikuar kerkesat, ankimet dhe vendimet perkatëse dhe eshtë i detyruar per te publikuar, perkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, perveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligji." Pra, nxjerrja dhe publikimi i Urdhërave të revokimit ne fagen e Qendres Kombëtare te Biznesit, eshte kompetence e institucioneve inspektuese, pezulluese, revokuese dhe jo QKB-së. Se dyti, prane institucionit tone, me date 22.04.2024, eshte depozituar nga ana e subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me shkresën me Nr.1135Prot., date 20.04.2024, "Vërtetim", i Gjykatës Administrative te Shkallës së Pare, Nr.extra Prot., date 18.04.2024, me objekt: "Marrjen e masës se sigurimit te padise, duke pezulluar zbatimin e aktit administrative 1997/5, date 04.04.2024, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit'. Kjo ceshtje eshte gjykuar dhe eshte vendosur: "1. Pranimi i kerkesës per marrjen e masës se sigurimit te padise. 2. Pezullimin e zbatimit te aktit administrative, Urdhër nr.141, date 04.04.2024, te Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit, deri ne zgjidhjen perfunditare te çështjes administrative". Referuar, nenit 14, pika 11, te ligjit nr. 10 081, date 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqiperise", i ndryshuar, QKB, ka percelle per kompetence, këte dokumentacion, Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencise Kombëtare të Mjedisit, me shkresën me nr. 3275/3Prot.,

date 25.04.2024, si institucion me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese. Se treti, ju bejme me dije se, nga verifikimi i kryer ne Regjistrin Kombetar te Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, rezulton se, subjekti "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, eshte pajisur me Leje Mjedisore te tipit A, me numer PN-8024-01-2019, ne date 31.01.2019. Me date 22.04.2022 eshte miratuar shtimi i veprimtarise se aktivitetit, me "Aktin e Miratimit" te Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit, Nr.3781Prot., date 22.04.2022. Se katërti, lidhur me pyetjen tuaj nëse leja mjedisore ka genë e vlefshme me date 15.03.2024, sqarojme se, ne Regjistrin Kombetar te Lejeve/Licencave dhe Autorizimeve, per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, rezulton i publikuar Urdhri i Ministrit nr. 141, date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me PN-8024- 01-2019, me veprimtari "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike". Per informacion me te detajuar lidhur me revokimin e Lejes se Mjedisit te tipit A, me numër PN- 8024-01-2019, per subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, lutemi t'i drejtoheni institucioneve me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese referuar ligjit nr. 10081, date 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqiperise" i ndryshuar.

Bashkëlidhur do të gjeni:

1. Kopje te Urdhrit te Ministrit nr. 141, date 04.04.2024 "Per pezullimin e lejes mjedisore për subjektin "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike", te publikuar ne fagen e webit www.gkb.gov.al.
2. Kopje te "Vërtetim", te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare, Nr.extra Prot., date 18.04.2024 së bashku me shkresën percjellese te subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, Nr. 1135Prot., date 20.04.2024.
- 3.. Kopje te Shkresës me Nr.3275/3Prot., date 25.04.2024 me lënde: "Percillet për kompetence", te Qendres Kombëtare te Biznesit.

III.1.7. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar ankesa e Operatorit ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK me nr. 1256/2024, datë 21.05.2024, bashkëlidhur Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. regj them 97, datë 11.04.2024, ku referuar kësaj të fundit, vëren se ky vendim lidhet me Akt - miratim Leje Mjedisore Tipi A, me numër identifikimi të lejes PN 8024-01-2019, referuar rrethanave të çështjes së Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. regj them 97, datë 11.04.2024, citohen disa nga hapat proceduralë, të cilat kanë ndodhur gjatë akteve të inspektimit nga AKM ndaj shoqërisë "V.A.L.E Recycling" SHPK. Referuar kësaj të fundit, citohet, se në datën 24.11.2024, në përfundim të inspektimit, është dorëzuar procesverbal i Inspektimit me Nr-AKM-DQ-2023-000521-2. Gjatë këtij inspektimi, janë përshkruar shkeljet ligjore "Gjetjet e konstatuara ne kete procesverbal bien ne kundërshtim me kerkesat e parashikuara nga neni/et e ligjit/eve: Neni 48. Ligji Nr. 10433 date 16.06.2011 "Per Inspektimin ne Republikën e Shqiperise" (pika 1 Komente: Subjekti per lejen e mjedisit Tipi A me PN 8024-01-2019 me titull instalimi "Incenerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incenerimi" ka te percaktuar 2. inceneratore EF 50 me kapacitet perpunues 60-100 kg/ cikel por nga verifikimi ne terren rezultoi se subjekti kishte te instaluar me vendodhe ushtrim aktiviteti vetem 1 incenerator EFS 50 me kapacitet perpunues 30- 50 kg/cikel. Referuar nenit 4 te ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" subjekti i lihet detyre te marie masat e menjehershme per percaktimin e sakte te instalimeve ne vendodhen e ushtrimit te aktivitetit sipas lejes mjedisore qe disponon me qellim pershtatjen e lejes mjedisore me instalimet perkatese ne vendndodhjen e ushtrimit te

aktivitetit instalimet perkatese ne vendndodhjen e ushtrimit te aktivitetit, duke vendosur denim administrativ kryesor, Paralajmerim” më pas pala kerkuese, me shkresën Nr. 6/1 prot. Date 06.12.2023 me lende "Plotesim dokumentacioni procedura e inspektimit Nr. Nr.-AKM-DQ-2023-000521", i ka berë me dije personit te trete Ministrise së Turizmit dhe Mjedisit, se per sa ishte konstatuar dhe nga Grupi i Inspektimit, mosfunksionimi i njerit prej Inceneratoreve nuk ishte ne gjendie pune per shkak te nje difekti Teknik dhe ishte nxjerrë nga funksioni si dhe kerkuesi po ndermente masat e menjehershme per zevendesimin e tij duke i paraqitur pales se paditur dhe faturen e blerjes se inceneratorit te ri me te njejtat parametra dhe teknologji. Me ane te shkreses Nr. 10411 Prot. Date 13.12.2023 te personit te trete me lende "Njoftim I vendimit perfundimtar te Inspektimit" eshte njoftuar pala kerkuese mbi vendimin perfundimtar te inspektimit me Nr. AKM-DQ-2023-000521-5 date 12.12.2023 me permbatje dhe denim i njejte me ate te procesverbalit te Inspektimit Ni.-AKM-DQ-2023-000521-2. por me afat te permbushjes se detyrave deri ne daten 24.01.2024.

Me shkresën Nr. 755 Prot. Date 15.01.2024 me lende "Kerkese per shtyrje afati/procedura e inspektimit Nr. AKM-DQ-2023-000521" kerkuesi i ka bërë me dije personit te trete se ka nisur menjehere me marrjen e masave per zevendesimin e inceneratorit te dale jashte funksionit duke i paraqitur faturen e blerjeve dhe i ka bere me dije se me date 23.12.2023 eshte bërë nisja nga Porti i Qingdao-QQCTU Qingdao Qiannean United CTN Kine drejt Portit te Durrësit, ka nisur riorganizimin e aktivitetit ne te githe instalimin duke saktësuar pajisjet ekzistuese, Zevendësimin e pajisjeve te demtuara, Instalimin e pajisjeve te reja si dhe nisjen e procedurave per ndryshimin e kushteve te Lejes Mjedisore me PN 8024-01-2019. Gjithashtu me ane te kesaj kerkese, ka kerkuar shtyjen e afatit te riinspektimit me te pakten 30 dite pune per shkak te voneses ne transportin e pajisjes se re te blere (incenerimit), Bashkelidhur kesaj kerkese kerkuesi i ka vëne ne dispozicion personit te trete nje kopje te dokumentacionit qe provonte pretendimet e tij.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se procedura e prokurimit publik objekt - ankimi është zhvilluar më datë 15.01.2024, ku me zhvillimin e procedurës nënkuptojme dhe afatin përfundimtar për dorëzimin e ofertave, pra operatori ekonomik ankimues është njohur me dokumentet e tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës, dhe në datën 15.01.2024, ku ky afat është i fundit në dorëzimin e ofertave të tyre, në përputhje me kërkesat për kualifikim të vendosura nga autoriteti kontraktor.

Referuar infomacionit të autoritetit kontraktor dhe komunikimeve me palet e treta vertetohet se operatori ekonomik ankimues në datën 15.01.2024, referuar shkresës nr. 755 prot., datë 15.01.2024, pasqyruar kjo në ankesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK me Nr. 1256/2024, datë 21.05.2024, bashkëlidhur vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. regj them 97, datë 11.04.2024, “V.A.L.E Recycling” SHPK pohon, se inceneratori ka dalë jashtë funksioneve. Leja mjedisore e kërkuar e tipit A është dhe arsyeja e skualifikimit nga autoriteti kontraktor. KPP gjykon, se me anë të kësaj lejeje përcaktohet apo vërtetohet mirëfeksionimi i inceneratoreve lidhur me objektin e kësaj lejeje mjedisore e cila ka te bëjë me “*incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi*”. Leja mjedisore jepet në kushtet kur subjekti që disponon këtë leje të tipit A, përmbush të gjitha kriteret e parashikuara nga legjisllacioni sektorial mjedisor për lëshimin e kësaj lejeje.

Gjithshtu, KPP verën, se referuar nenit të 76 të LPP të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku citohet se [...] “ *autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku republika e shqipërisë është palë; duke marrë parasysh rastin kur një operator ekonomik përjashtohet të lidhë kontratë nëse autoriteti ose enti kontraktor provon, se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin mjedisor, lidhur me evindentimin e kryer nga Komisioni i Prokurimit Publik për procedurën e rivlerësimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, ku operatori ekonomik ka kryer shkelje të ligjit dhe rregullave të prokurimit, si dhe parimeve kryesore të tij që lidhen me transparencën, referuar çështjes të mësipërme, vlerëson se është në të drejtën e autoritetit kontraktor, që në bazë të konstatimeve të kryera prej tij, të skualifikojë operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, duke qenë se vlerëson bindjen, se ky operator ekonomik nuk do të realizojë me sukses procedurën e produrimit objekt - ankimi, pasi nuk provon se disponon pajisje në përputhje me lejen e lëshuar.*

Gjithashtu, duke e parë në këtë këndvështrim, komisioni vlerëson, se referuar kriterit dhe momentit procedural për të cilin operatori ekonomik në përmbushje të kesaj kërkesë ka qenë në dijeni më problematikat lidhur me inspektimin e parë të AKM në datën 23.11.2023, ndodhemi para faktit se operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor, referuar kapaciteteve të kërkuara në përmbushje të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni gjykon, se arsyeja e dhënë nga ana e autoritetit kontraktor për skualifikimin e operatorit ekonomik është e drejtë.

Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me nr REF-86181-11-02-2023 me objekt “*Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT*” për 12 muaj” me fond limit 1,409,700.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri